

P. nr.197/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit **Sh.C.** nga Gj., për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325/1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë, PP.nr.1156/15 të datës 07.04.2016, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë **09.12.2016**, në prani të Prokurorit të shtetit Mone Syla si dhe te akuzuarit , mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **Sh.C.** nga Gj., Rr ”P.V.” nr. 2, i biri i M. dhe i nënës H. e gjinisë P. i lindur me dt... ne Gj., analfabet, i pa punë, i gjendjes se varfër ekonomike, ashkali, shtetas i R. Kosovës, i pa martuar.

Ë s h t ë f a j t o r :**Sepse:**

-me dt. 07.09.2015, ne Gjakovë , ne rrugën “G.P”, rreth orës 14.15, me qëllim që vetit apo tjetrit ti sjelli përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim vjedhje ,shkon në objektin e të dëmtuarës NSH “F.” Gj., e futet brenda në objekt dhe vjedhë, duke e mbushur me hekura një karrocë dore, e kur hetohet e kapet në flagrancë nga roja, i akuzuari me një copëz hekuri në dore e kanos rojën, e me karrocë dore të mbushur me hekura me të shpejt, largohet në drejtim të pa ditur, e të dëmtuarës i shkakton dëme të konsideruar material.

-me çka ka kryer veprën penale te vjedhjes nga neni 325/1 te KPRK-ës .

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,46,49,50,51,52 par.5, 73 ,neni 325/1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **3(tre) muajve** dhe dënim me gjobë ne shumë prej **100.00 (njëqind) euro**, të cilat dënime nuk do te ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I dëmtuari N.SH “F.”, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20 ,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore - DP në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën PP.nr.1156/15 të dt. 07.04.2016, kundër të akuzuarit **Sh.C.** nga Gjakova, për shkak se ka kryer veprën penale të vjedhjes nga neni 325/1 të KPRK-ës, duke propozuar qe i njëjti te shpallet fajtor, te dënohet sipas ligjit si dhe te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjykata me qene se i akuzuari **Sh.C.** është shurdhe-memec, i gjendjes se varfër ekonomike, gjykata ka siguruar mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av. G.G., njëkohësisht është ftuar edhe personi qe

mund te komunikojë me te perf. ligjor –prindi M.C., mirëpo ne gjykate është paraqitur vëllai i tij D.C. pasi qe prindi i tyre është ne spital ne Prishtinë për shkak te gjendjes jo të mirë shëndetësore .

Gjykata gjithashtu konstaton se deri te ky angazhim i perf. ligjor gjegjësisht personit qe mund te komunikon me te pandehurin është marr bazuar ne nenin 153/2 te KPP-ës, me qene se për te njëjtin nuk mund te përcaktohet përkthyes-interpret i kualifikuar ngase i akuzuari nuk e njeh gjuhen e shenjave apo me shkrim por atë e kuptojnë vetëm anëtarët e familjes.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me të datë 09.12.2016, Prokurori i shtetit Mone Sylja, lexojë aktakuzën PP.nr.1156/15 të dt. 07.04.2016, dhe deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari me qene se i akuzuari ka pranuar fajësinë dhe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimit te fajësisë e qe ky pranim ka edhe mbështetje edhe ne shkresat e lendes.

I akuzuari **Sh.C.** gjatë shqyrtimit fillestar deklaroi se pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. G.G., ne prezencën e përcjellësit te tij –vëllait D.C. e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se jam penduar për veprën e kryer, këtë vepër e kam kryer për shkak te gjendjes se varfër ekonomike pasi jam i pa punë, për çka para gjykatës kërkojë falje nga kinse këtu e dëmtuara gjithnjë duke llogaritur se ato kanë qene vetëm mbeturina, andaj gjykatës i propozoi qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi e fajësisë, gjendje e varfër ekonomike, premtimin se me nuk do te përsërisë vepra te tilla, te me shqiptojë një dënim me te butë.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari **Sh.C.** me dt. 07.09.2015, ne Gjakovë , ne rrugën “G.K.”, rreth orës 14.15, me qëllim që vetit apo tjetrit ti sjelli përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim vjedhje, shkon në objektin e të dëmtuarës NSH “F.” në Gjakovë, e futet brenda në objekt dhe vjedhë, duke e mbushur me hekura një karrocë dore, e kur hetohet e kapet në flagrancë nga roja, i akuzuari me një copëz hekuri në dore e kanos rojën, e me karrocë dore të mbushur me hekura me të shpejt, largohet në drejtim të pa ditur, e të dëmtuarës i shkakton dëme të konsideruar material.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza, ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit, me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari në çdo fazë të procedurës, personalitetin e tij, pendimin e shprehur ne gjykatë, sjelljen korrekte, gjendjen e varfër ekonomike, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **3 (tre)** muajve dhe dënim

me gjobë ne shumë prej **100.00 (njëqind) euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 197/16 më datë 09.12.2016.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes së tij në dorëzim Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.